

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

K R Y E T A R I

Nr. 130/6 Prot.

Tiranë, më 30/05/2016

V E N D I M

Nr. 58, Datë 30.05.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t, ELBASAN “MBI VLERËSIMIN E
AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROÇEDURAT E SHQYRTIMIT
DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE
INFORMALE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Elbasan, për periudhën nga data 01.10.2013 deri me datë 28.02.2016 .

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në 22 **praktika**, lejet e legalizimit nuk janë lëshuar brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 17-21, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa që për çdo rast lejet e legalizimit të lëshohen brenda afatit të 30 ditorë të përcaktuar në ligj.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer, u konstatua se ka objekte informale, të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim, duke mos zbatuar procedurat për s’kualifikimin e tyre, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, pikën 5 të nenit 2 dhe 39-*Përfundimtar nga Legalizimi*, kapitulli IV, i VKM nr. 438, datë 28.06.2006, urdhrit nr. 291, datë 01.09.2008 dhe nr. 846, datë 11.10.2012, si dhe pikat 2 dhe 3 të neni 42, të VKM nr. 40 datë 11.01.2012 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 14-17, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa që për objektet informale të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për legalizim, të ndiqen procedurat e s’kualifikimit të tyre.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në 16 **praktika**, sipërfaqja e legalizuar (si kufi) është më e madhe se sa ligji e lejon (3 fish e bazës deri në 500 m² për ambiente banimi), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Për këto praktika është kërkuar ndryshimi i statusit juridik të parcelës ndërtimore (nga arë në truall) për sipërfaqen 17789.1 m², duke rënduar buxhetin e shtetit në rast shpronësimi (kompensimi) të sipërfaqeve nga arë në truall (*Trajtuar më hollësisht në faqen 26-34, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa që sipërfaqja e parcelës ndërtimore të legalizuar të jetë 3 fish e bazës së objektit deri në 500 m² për objektet me destinacion banimi.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në 26 **praktika**, legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, pasi:

-Në 7 **praktika**, në Bashkinë Belsh janë kryer legalizime të objekteve në kufirin mbrojtës të liqenit, ku sipas ortofoto dixhitale të fotografimit ajror dhe dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Elbasan, parcelat ndërtimore ndodhen në llojin e pasurisë “*liqen*”, veprime në kundërshtim me pikën 5 e nenit 2 dhe nenin 3, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe paragrafi 3/iii e pikës 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 65-71, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

-**Në 1 (një) rast**, objekti informal i legalizuar nuk ka ruajtur distancat e lejuara me shtratin e lumit Shkumbin, veprime në kundërshtim me pikën 5 e nenit 2 dhe nenin 3, të ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe pikën 2, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 71-72, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

-**Në 16 praktika**, objektet e legalizuar nuk respektojnë distancat me strukturën e rrugëve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pikën 2/a, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, si dhe nenin 27, të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 21-26, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

-**Në 1 (një) praktik**, objekti informal nuk ka respektuar distancën me brezin mbrojtës të kanalit kullues, veprime në kundërshtim me germën “e” e pikës 2, të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, germën “ç” e neni 56, të ligjit nr. 9860, datë 21.01.2008 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për Ujitjen dhe Kullimin” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 72-73, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

-**Në 1 (një) praktik**, objekti informal është legalizuar në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, paragrafi parë dhe neni 45/1, pasi nuk rezultoi i ndërtuar deri me datë 15.01.2009, sipas pamjeve në Google Earth (*Trajtuar më hollësisht në faqen 74-76, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t’i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi, të fillojë procedurat, për rishikimin dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Brenda datës 30.07.2016

5. Gjetje nga auditimi: Në **20 praktika**, objektet informale janë legalizuar në prona shtetërore dhe publike, duke lidhur kontrata për shitjen e parcelave ndërtimore dhe bërë ndarje (parcelizime) të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore mbi kufirin 300 m² - 500 m², por që nuk ka dokumentacion për të vërtetuar faktin se diferencat e sipërfaqes së shkurtuar për shkak të përmasave ose konfiguracionit mund të shfrytëzohet më vete për ndërtim ose jo.

Gjithashtu këto sipërfaqe të legalizuara janë më të vogla se sipërfaqja që grupi i ekspertëve në terren ka konstatuar, ku për këtë mospërputhje në dosjet e audituar nuk u gjend dokumentacion ligjor për argumentimin e tyre dhe lënien jashtë procesit të legalizimit.

Nuk gjendet asnjë shkresë e Bashkisë Elbasan, lidhur me kërkesat dhe projektet e këtyre njësive të qeverisjes vendore për të kryer ndërtime dhe zhvilluar infrastrukturën në këto praktika, veprime në kundërshtim me pikën “f” e nenit 3 dhe nenin 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, për sipërfaqen e përgjithshme prej **4117.76 m²** me një vlerë prej **40,468,221 lekë**, e ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për fondin e krijuar për kompensimin e ish-pronarëve (*Trajtuar më hollësisht në faqen 89-101, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa dhe të ndjek procedurat administrative, duke iniciuar me poseduesit e parcelës ndërtimore për korigjimin e 20 kontratave të shitjes së truallit me sipërfaqe 4117.76 m², për të cilën është arkëtuar më pak vlera **40,468,221 lekë**, duke bashkëpunuar dhe me NJQV dhe ZVRPP^{në}.

Brenda datës 30.07.2016

6. Gjetje nga auditimi: Në **27 praktika**, prona e legalizuar është e mbivendosur në prona të tjera kryesisht "rrugë" dhe në pronë “shtet”, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" pika 2/c, si dhe urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008, pika 2.4 dhe rregulloren e brendshme, Kapitulli VI (*Trajtuar më hollësisht në faqen 53-65, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan në bashkëpunim me ZVRPP Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin dhe ZQRPP, të marrë masa për saktësimin e pronës të objekteve të legalizuar dhe për rastet kur ka konflikt **të vendoset kufizimi (shënim hipotekor), deri në zgjidhjen në rrugë gjyqësore.**

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni në dosjet e objekteve të legalizuara, u konstatua se kërkesa për statusin juridik të pronës nuk është e plotë, pasi mungon informacioni mbi kufitarët dhe harta treguese. Në 60% të praktikave është operuar me statuse të vjetra (*mbi 3 muaj*), duke mos marrë informacion tjetër për statusin juridik të pronës, nëse ato mund të kenë pësuar ndryshime në kohe, volum dhe pronësi. Gjithashtu, ka dhe praktika ku vijimi i procedurave të legalizimit është kryer pa marrë konfirmim mbi statusin juridik të pronës, veprime në kundërshtim me germën “d” e nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 258, datë 04.05.2007 "Për regjistrimin fillestar të pasurisë që legalizohet", Memorandumit të Mirëkuptimit e Bashkëpunimit datë 26.07.2007, VKM Nr. 688, datë 29.07.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 332, datë 12.03.2008 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, të përftuar nga fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë”, germën “h” e pikës 1, të urdhrin nr. 46, datë 08.11.2006, urdhrin nr. 195, datë 26.03.2012 “Për miratimin e manualit mbi mënyrën e plotësimit dhe administrimit të lejes së legalizimit”, si dhe udhëzimin nr. 958, datë 18.12.2012 “Për mënyrën e hartimit, paraqitjen dhe përmbajtjen e dokumentacionit tekniko-ligjorë për

propozimin e kalimit të së drejtës së pronës mbi parcelën ndërtimore të objektit informal dhe kompensimit financiar të pronarëve" (*Trajtuar më hollësisht në faqen 14-17, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan të marrë masa që të gjitha objektet informale që legalizohen, të merret konfirmimi mbi statusin juridik të pronës dhe ky brenda afatit 3 muajorë nga momenti i kualifikimit të dosjes.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, nuk ka zbatuar pikën 11, të VKM nr. 488, datë 22.07.2014 "Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës" dhe pikat 22 dhe 23, të VKM nr. 1095, datë 28.12.2015 "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës midis ZQRPP dhe ALUIZNI-t dhe të procedurave apo kufizimit të pasurive të legalizuara", mbi evidentimin e personave me pagesë të energjisë elektrike në aftin një vjeçar, veprime të cilat çojnë në përfitimin e padrejtë të shumës së ngurtësuar prej 10% të vlerës së parcelës ndërtimore, si e ardhur e munguar në fondin e kompensimit të ish-pronarëve (*Trajtuar më hollësisht në faqen 14-17, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa për evidentimin e subjekteve të cilët nuk kanë kryer pagesën e energjisë elektrike pas afatit një vjeçar, duke kërkuar vendosjen "kufizim pasurie" në ZVRPP deri në likuidimin e vlerës së detyrimit të falur prej 10 % (garancinë), ose paraqitjen e pagesës së energjisë elektrike.

Brenda datës 30.07.2016

9. Gjetje nga auditimi: Në 10 praktika, mungojnë dokumentet që të vërtetojnë nëse objekti informal është ndërtuar para vitit 1993, apo me leje ndërtimi pas këtij viti, veprim në kundërshtim me nenin 36, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar. Gjithashtu, mungojnë deklaratat noteriale, ku projektuesi i licencuar i konstruksionit të ndërtimit, zbatuesi dhe investitori të garantojnë së bashku qëndrueshmërinë konstruktive të objektit të legalizuar dhe shoqëruar me oponencën e institucioneve të specializuara, veprime në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 79-81, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa dhe të zbatojë legjislacionin në fuqi, lidhur me legalizimin e shtesave informale në objekte me leje ndërtimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 50, datë 15.05.2014 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dalë në zbatim të tij, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **19 raste me vlerë 5,302,119 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në **16 praktika**, llogaritja e vlerës së parcelës ndërtimore është bërë në referencë të VKM nr. 187, datë 06.03.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të RSH”, duke përcaktuar çmim/m² sipas zonave kadastrale, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndodhen në të gjithë Bashkitë dhe disa Komuna”.

Gjithashtu evidentohen dhe praktika ku vlera e parcelës ndërtimore nuk është llogaritur, duke konstatuar një **dëm ekonomik në vlerën 4,282,918 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqen 82-89, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së parcelës ndërtimore prej **4,282,918 lekë**, ndajë personave: Sh. B. në shumën 708,523 lekë; Y.M. në shumën 322,019 lekë; Z.K. në shumën 303,841 lekë; A.H. në shumën 289,572 lekë; F.P. në shumën 76,309 lekë; Xh.Q. në shumën 9,576 lekë; T.H., R.H. në shumën 87,631 lekë; Sh.S. në shumën 236,891 lekë; A.K. në shumën 376,829 lekë; K.N. në shumën 58,444 lekë; N.A. në shumën 205,042 lekë; F.D. në shumën 390,541 lekë; A.M. në shumën 645,216 lekë; A.R. në shumën 158,748 lekë; G.V. në shumën 316,536 lekë dhe Xh.Gj. në shumën 28,000 lekë.

Brenda datës 30.07.2016

2. Gjetje nga auditimi: Në dosjet e personave të pajisur me leje legalizimi, u konstatua se nuk ka dokumentacion ligjorë për të vërtetuar pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, kjo në **2 praktika me vlerë 59,201 lekë**, si mungesë të ardhurash në buxhetin e Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV), veprime këto në kundërshtim me germën “ç” të nenin 27, të ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 81-82, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan në bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Elbasan, të marrin masa duke ndjekur rrugët ligjore për llogaritjen, saktësimin dhe arkëtimin e vlerës së taksës së infrastrukturës, ndaj **2 personave me vlerë 59,201 lekë**.

Brenda datës 30.06.2016

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të fondeve me prokurim me vlerë kontrate 9,600,000 lekë (me tvsh), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit. Në zhvillimin e tenderit kundrejt fondit dhe çmimit nuk është caktuar sasia e kateve, konkurrim që duhej bërë për 1000 kate, duke fituar vlera e ofertës më të ulët. Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), nuk është kualifikuar fituese firma që ka paraqitur vlerën më të ulët të ofertës, duke çuar në mospërdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **960,000 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqen 113-117, të Raport Përfundimtar Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e ALUIZNI-t Elbasan, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **960,000 lekë**, nga operatori ekonomik “L & C” me përfaqësues ligjor **z. L.Z.**

Brenda datës 30.07.2016

4. Për të gjithë praktikatat e evidentuara në pikën 1 dhe 2, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Elbasan në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, Tiranë, të marrë masa dhe të njoftojë ZVRPP Elbasan, Librazhd, Gramsh, Peqin dhe ZQRPP, **për vendosjen e kufizimit (shënim hipotekor), deri në shlyerjen e detyrimit për tu nxjerrë.**

C. MASA DISIPLINORE:

C/1. Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neneve 11 dhe 12 të kontratës individuale të punës, **i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë**, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për **3 punonjës**, si më poshtë:

“Largim nga puna (Zgjidhje e kontratës)”.

1. M.S., me detyrë Përgjegjës në Sektorit të Çështjeve të Pronësisë.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Mungesa e informacionit sipas koordinatave të statusit juridik të pronës, kryerja e veprimeve me statuse juridik të vjetra (*mbi 3 muaj*), mos rifreskimi i informacionin mbi të dhënat e statusit juridik, duke lënë jashtë vëmendjes faktin se prona mund të kenë pësuar ndryshime në kohe, volum, pronësi, etj, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje“, i ndryshuar, VKM nr. 258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin fillestar të pasurisë që legalizohet”, Memorandumit të Mirëkuptimit e Bashkëpunimit datë 26.07.2007, VKM nr. 688, datë 29.07.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 332, datë 12.03.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, të përfutur nga fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Gjithashtu, konstatohet dhe praktika ku procesi i legalizimit të objekteve informale është kryer pa marrë konfirmim mbi statusin juridik të pronës, veprime në kundërshtim me

germën “d” e nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, germën “h” të pikës 1, të urdhrorit nr. 46, datë 08.11.2006, pikën 6, të urdhrorit nr. 195, datë 26.03.2012 “Për miratimin e manualit mbi mënyrën e plotësimit dhe administrimit të lejes së legalizimit” dhe pikën 4, të udhëzimit nr. 958, datë 18.12.2012 “Për mënyrën e hartimit, paraqitjen dhe përmbajtjen e dokumentacionit tekniko-ligjorë për propozimin e kalimit të së drejtës së pronës mbi parcelën ndërtimore të objektit informal dhe kompensimit financiar të pronarëve. (Trajtuar më hollësisht në faqen 14-17, të Raport Përfundimtar Auditimit).

-**Në 16 praktika**, objektet informale janë legalizuar në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 2/c, si dhe urdhrorit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008, pika 2.4, pasi kemi mbivendosje të pronës së legalizuar me prona të tjera kryesisht “rrugë” dhe në pronë “shtet” (Trajtuar më hollësisht në faqen 45-46, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 11 & 26, datë 31.03.2016).

-**Në 14 praktika**, sipërfaqja e legalizuar (si kufi) është më e madhe se 3 fish e bazës së objektit deri në 500 m² (për ambiente banimi), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, duke rënduar buxhetin e shtetit dhe rritur padrejtësisht vlerën e kompensimit të parcelave në rast shpronësimi (nga arë në truall) (Trajtuar më hollësisht në faqen 26-34, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 19, datë 31.03.2016).

Në 1 (një) praktikë, objektet informale janë legalizuar në kundërshtim me germën “e” e pikës 2, të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo” dhe germën “ç” e nenit 56, të ligjit nr. 9860, datë 21.01.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për Ujitjen dhe Kullimin”, duke mos respektuar distancën me brezin mbrojtës të kanalit kullues (Trajtuar më hollësisht në faqen 72-74, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 21, datë 31.03.2016)

-**Në 17 praktika**, parcela ndërtimore në zona informale të pamiratuara në KKT dhe regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Ullishte, Pemishte”, legalizimi është kryer në zona “Territore të tjera”, në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.05.2009 “Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale”, duke ndryshuar zërin kadastral dhe regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall” (Trajtuar më hollësisht në faqen 34-53, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 12 & 23, datë 31.03.2016).

-**Në 1 (një) praktikë**, objekti informal është legalizuar në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, paragrafi parë dhe neni 45/1, pasi nuk rezultonin të ndërtuar deri me

datë 15.01.2009, kjo sipas pamjeve në Google Earth (*Trajtuar më hollësisht në faqen 74-76, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 24, datë 31.03.2016*).

-Në 2 praktika, janë legalizuar ndërtimet pa leje në sipërfaqe tokë shtetërore dhe publike, duke bërë ndarje (parcelizime) mbi kufijtë 300 m² brenda vijës së verdhë dhe mbi 500 m² jashtë vijës së verdhë, por që nuk ka dokumentacion që të vërtetojë faktin se diferenca e sipërfaqes së shkurtuar për shkak të përmasave ose konfiguracionit mund të shfrytëzohet më vete për ndërtim. Gjithashtu, sipërfaqja e legalizuar është më e vogël se sipërfaqja që grupi i ekspertëve në terren ka konstatuar dhe në dosjet e audituar nuk u gjend dokumentacion ligjor për argumentimin e këtyre diferencave, veprime këto në kundërshtim me pikën “f” e nenit 3 dhe nenin 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Nga mos shitja e sipërfaqeve, rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për llogari të fondit për kompensimin e ish-pronarëve në vlerën **563,120 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqen 89-101, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 5 & 18, datë 31.03.2016*).

2. Sh.P, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë dhe përpunimit të informacionit, në cilësinë e ish-P/ Sektorit të Çështjeve të Pronësisë.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Mungesa e informacionit sipas koordinatave të statusit juridik të pronës, kryerja e veprimeve me statuse juridik të vjetra (*mbi 3 muaj*), mos rifreskimi i informacionin mbi të dhënat e statusit juridik, duke lënë jashtë vëmendjes faktin se prona mund të kenë pësuar ndryshime në kohe, volum, pronësi, etj, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin fillestar të pasurisë që legalizohet”, Memorandumit të Mirëkuptimit e Bashkëpunimit datë 26.07.2007, VKM nr. 688, datë 29.7.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 332, datë 12.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, të përfutur nga fotografimi ajror, dixhital i territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Gjithashtu, konstatohet dhe praktika ku procesi i legalizimit të objekteve informale është kryer pa marrë konfirmim mbi statusin juridik të pronës, veprime në kundërshtim me germën “d” e nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar, germën “h” të pikës 1, të urdhrit nr. 46, datë 08.11.2006, pikën 6, të urdhrit nr. 195, datë 26.03.2012 “Për miratimin e manualit mbi mënyrën e plotësimit dhe administrimit të lejes së legalizimit” dhe pikën 4, të udhëzimit nr. 958, datë 18.12.2012 “Për mënyrën e hartimit, paraqitjen dhe përmbajtjen e dokumentacionit tekniko-ligjorë për propozimin e kalimit të së drejtës së pronës mbi parcelën ndërtimore të objektit informal dhe kompensimit financiar të pronarëve. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 14-17, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 15, datë 31.03.2016*).

-Në 14 praktika, objektet informale janë legalizuar në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i

ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" pika 2/c, si dhe urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008, pika 2.4, pasi kemi mbivendosje të pronës së legalizuar me prona të tjera kryesisht "rrugë" dhe në pronë "shtet" (*Trajtuar më hollësisht në faqen 53-65, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 11 & 26, datë 31.03.2016*).

-**Në 13 praktika**, sipërfaqja e legalizuar (si kufi) është më e madhe se 3 fish e bazës së objektit deri në 500 m² (për ambiente banimi), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, duke rënduar buxhetin e shtetit dhe rritur padrejtësisht vlerën e kompensimit të parcelave në rast shpronësimi nga arë në truall (*Trajtuar më hollësisht në faqen 26-34, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 19, datë 31.03.2016*).

-**Në 16 praktika**, parcela ndërtimore e zënë në zona informale të pamiratuara në KKT dhe regjistruar në pasurinë e llojit "Arë, Ullishte, Pemishte", legalizimi është kryer në zona "Territore të tjera", në kundërshtim me nenet 10, 11, 14, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar dhe VKM nr. 515, datë 13.05.2009 "Për përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe kohës së ushtrimit nga ALUIZNI të përgjegjësive të zyrave të urbanistikës dhe të këshillave të qarqeve, gjatë procedurave të legalizimit të objekteve informale", duke ndryshuar zërin kadastral dhe regjimin e tokës në llojin e pasurisë "Truall" (*Trajtuar më hollësisht në faqen 34-53, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 12 & 23, datë 31.03.2016*).

-**Në 1 (një) praktikë**, objektet informale janë legalizuar në kundërshtim me germën "e" e pikës 2, të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" dhe germën "ç" e nenit 56, të ligjit nr. 9860, datë 21.01.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 "Për Ujitjen dhe Kullimin", duke mos respektuar distancën me brezin mbrojtës të kanalit kullues (*Trajtuar më hollësisht në faqen 72-74, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 21, datë 31.03.2016*).

-**Në 1 (një) praktikë**, objekti informal është legalizuar në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, paragrafi parë dhe neni 45/1, pasi nuk rezultonin të ndërtuar deri me datë 15.01.2009, kjo sipas pamjeve në Google Earth (*Trajtuar më hollësisht në faqen 74-76, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 24, datë 31.03.2016*).

-**Në 2 praktika**, janë legalizuar ndërtimet pa leje në sipërfaqe tokë shtetërore dhe publike, duke bërë ndarje (parcelizime) mbi kufijtë 300 m² brenda vijës së verdhë dhe mbi 500 m² jashtë vijës së verdhë, por që nuk ka dokumentacion që të vërtetojë faktin se diferenca e sipërfaqes së shkurtuar për shkak të përmasave ose konfiguracionit mund të shfrytëzohet më vete për ndërtim. Gjithashtu, sipërfaqja e legalizuar është më e vogël se sipërfaqja që grupi i ekspertëve në terren ka konstatuar dhe në dosjet e audituar nuk u gjend dokumentacion ligjor për argumentimin e këtyre diferencave, veprime këto në

kundërshtim me pikën “f” e nenit 3 dhe nenin 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Nga mos shitja e sipërfaqeve, rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për llogari të fondit për kompensimin e ish-pronarëve në vlerën **563,120 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqen 89-101, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 5 & 18, datë 31.03.2016*).

“Vërejtje me shkrim”.

1. A.L., me detyrë specialist në sektorin e Legalizimit dhe Planifikimit Urban ALUIZNI Tiranë, në cilësinë e ish-Drejtorit të ALUIZNI-t Elbasan.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Mos s’kualifikimin e objekteve informale të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore, veprime në kundërshtim me nenit 2, pika 5, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, kreut të dytë nenit 4, pika 1 shkronja (b).për objektet e shkualifikuar dhe ngritjen e të dhënave të tyre, sipas VKM nr. 438, datë 28.06.2006, kapitulli IV. Informatizimi i të dhënave, pika 22 (*Trajtuar më hollësisht në faqen 12-17, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 6, datë 25.03.2016*).

-Mos legalizim i objekteve informale brenda afatit 30 ditë, siç përcaktohet në nenin 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 17-21, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 8 & 15, datë 31.03.2016*).

-**Në 8 praktika**, objektet informale të legalizuar nuk respektojnë distancat e lejuara me strukturën e trupit të rrugës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pikën 2/a, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", si dhe nenit 27, të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 21-26, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 4, 6 & 17, datë 31.03.2016*).

-**Në 1 (një) praktikë**, sipërfaqja e legalizuar (si kufi) është më e madhe se 3 fish e bazës së objektit deri në 500 m² (për ambiente banimi), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, duke rënduar buxhetin e shtetit dhe rritur padrejtësisht vlerën e kompensimit të parcelave në rast shpronësimi (nga arë në truall) (*Trajtuar më hollësisht në faqen 26-34, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 19, datë 31.03.2016*).

-**Në 2 praktika**, objektet informale janë legalizuar në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për

përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" pika 2/c, si dhe urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008, pika 2.4, pasi kemi mbivendosje të pronës së legalizuar me prona të tjera kryesisht "rrugë" dhe në pronë "shtet" (Trajtuar më hollësisht në faqen 53-65, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 26, datë 31.03.2016).

-**Në 1 (një) praktikë**, objektet informale janë legalizuar në kundërshtim me germën "e" e pikës 2, të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo" dhe germën "ç" e nenit 56, të ligjit nr. 9860, datë 21.01.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 "Për Ujitjen dhe Kullimin", duke mos respektuar distancën me brezin mbrojtës të kanalit kullues (Trajtuar më hollësisht në faqen 72-74, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 21, datë 31.03.2016).

-**Në 1 (një) praktikë**, janë legalizuar ndërtimet pa leje në sipërfaqe tokë shtetërore dhe publike, duke bërë ndarje (parcelizime) mbi kufijtë 300 m² brenda vijës së verdhë dhe mbi 500 m² jashtë vijës së verdhë, por që nuk ka dokumentacion që të vërtetojë faktin se diferenca e sipërfaqes së shkurtuar për shkak të përmasave ose konfiguracionit mund të shfrytëzohet më vete për ndërtim. Gjithashtu, sipërfaqja e legalizuar është më e vogël se sipërfaqja që grupi i ekspertëve në terren ka konstatuar dhe në dosjet e audituar nuk u gjend dokumentacion ligjor për argumentimin e këtyre diferencave, veprime këto në kundërshtim me pikën "f" e nenit 3 dhe nenin 17, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar.

Nga mos shitja e sipërfaqeve, rezultojnë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për llogari të fondit për kompensimin e ish-pronarëve në vlerën **176,600 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqen 89-101, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 13 & 16, datë 31.03.2016).

C/2. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe neneve 11 dhe 12, të kontratës individuale të punës, **i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t Tiranë**, që bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", me ndryshime dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara nga "**Vërejtje**" deri në "**Zgjidhjen e Kontratës së Punës**", për **5 punonjës**, si më poshtë:

1. B.V., me detyrë specialist në sektorin e Legalizimit dhe Planifikimit Urban, në cilësinë e ish-P/Sektorit të Legalizimit dhe Planifikimit Urban.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Mos skualifikimin e objekteve informale të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore, veprime në kundërshtim me nenit 2, pika 5, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin,

urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, kreut të dytë nenit 4, pika 1 shkronja (b).për objektet e shkualifikuar dhe ngritjen e të dhënave të tyre, sipas VKM nr. 438, datë 28.06.2006, kapitulli IV. Informatizimi i të dhënave, pika 22 *(Trajtuar më hollësisht në faqen 14-17, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 6, datë 25.03.2016)*.

-Mos legalizim i objekteve informale brenda afatit 30 ditë, siç përcaktohet në nenin 28, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në faqen 17-21, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 8 & 15, datë 31.03.2016)*.

-**Në 13 praktika**, objektet informale të legalizuar nuk respektojnë distancat e lejuara me strukturën e trupit të rrugës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pikën 2/a, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, si dhe nenit 27, të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar *(Trajtuar më hollësisht në faqen 21-26, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 4,6 & 17, datë 31.03.2016)*.

-**Në 2 praktika**, sipërfaqja e legalizuar (si kufi) është më e madhe se 3 fish e bazës së objektit deri në 500 m² (për ambiente banimi), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, duke rënduar buxhetin e shtetit dhe rritur padrejtësisht vlerën e kompensimit të parcelave në rast shpronësimi nga arë në truall *(Trajtuar më hollësisht në faqen 26-34, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 19, datë 31.03.2016)*.

Në 1 (një) praktikë, objektet informale janë legalizuar në kundërshtim me germën “e” e pikës 2, të VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo” dhe germën “ç” e nenit 56, të ligjit nr. 9860, datë 21.01.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për Ujitjen dhe Kullimin”, duke mos respektuar distancën me brezin mbrojtës të kanalit kullues *(Trajtuar më hollësisht në faqen 72-74, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 21, datë 31.03.2016)*.

-**Në 2 praktika**, në dosje mungonte dokumentacion ligjorë që të vërtetonte pagesën e taksës së ndikimit të infrastrukturë të objekteve për vlerën **59,201 lekë dëm ekonomik**, veprime në kundërshtim me germën “ç” të nenit 27, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 me ndryshime në ligjin nr. 50/2014 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” *(Trajtuar më hollësisht në faqen 82-89, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 5 & 18, datë 31.03.2016)*.

2. H.P., me detyrë specialist në Sektorin Hartografisë, në cilësinë e specialistit të Sek/Çështjeve të Pronësisë.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet

informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-**Në 3 praktika**, objektet informale janë legalizuar në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” pika 2/c, si dhe urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008, pika 2.4, pasi kemi mbivendosje të pronës së legalizuar me prona të tjera kryesisht “rrugë” dhe në pronë “shtet” (Trajtuar më hollësisht në faqen 53-65, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 11 & 26, datë 31.03.2016).

-**Në 7 praktika**, në Bashkinë Belsh, janë kryer legalizime të objekteve në kufirin mbrojtës të liqenit, ku siç tregohet nga ortofoto dixhitale të fotografimit ajror dhe dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Elbasan, parcelat ndërtimore të zëna, ndodhen të regjistruara në zonën përkatëse, në llojin e pasurisë “Liqen”, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, nenin 3, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, pika 2, paragrafi 3/iii (Trajtuar më hollësisht në faqen 65-71, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 7 & 20, datë 31.03.2016).

-**Në 1 (një) praktikë**, legalizimi i objekti nuk ka ruajtur distancat e lejuara me shtratin e lumit Shkumbin, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, nenin 3, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, pika 2 (Trajtuar më hollësisht në faqen 71-72, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 7, datë 31.03.2016).

3. A.B., me detyrë specialist në Sektorin e Legalizimit dhe Planifikimit Urban.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-**Në 9 praktika**, objektet informale të legalizuar nuk respektojnë distancat e lejuara me strukturën e trupit të rrugës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pikën 2/a, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, si dhe nenin 27, të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqen 21-26, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 4,6 & 17, datë 31.03.2016).

-**Në 15 praktika**, sipërfaqja e legalizuar (si kufi) është më e madhe se 3 fish e bazës së objektit deri në 500 m² (për ambiente banimi), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa

në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, duke rënduar buxhetin e shtetit dhe rritur padrejtësisht vlerën e kompensimit të parcelave në rast shpronësimi (nga arë në truall) *(Trajtuar më hollësisht në faqen 26-34, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 19, datë 31.03.2016).*

4. A.M., me detyrë specialist në Sektorin Çështjeve të Pronësisë.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Në 15 praktika, sipërfaqja e legalizuar (si kufi) është më e madhe se 3 fish e bazës së objektit deri në 500 m² (për ambiente banimi), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, duke rënduar buxhetin e shtetit dhe rritur padrejtësisht vlerën e kompensimit të parcelave në rast shpronësimi nga arë në truall *(Trajtuar më hollësisht në faqen 26-34, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 19, datë 31.03.2016).*

-Në 1(një) praktikë, objektet janë legalizuar në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, paragrafi parë dhe neni 45/1, pasi objektet nuk rezultonin të ndërtuar deri me datë 15.01.2009, kjo sipas pamjeve në Google Earth *(Trajtuar më hollësisht në faqen 74-76, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 24, datë 31.03.2016).*

-Në 18 praktika, prona e legalizuar është e mbivendosur në prona të tjera kryesisht "rrugë" dhe në pronë “shtet”, veprime në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje" pika 2/c, si dhe urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 291, datë 01.09.2008, pika 2.4 dhe rregulloren e brendshme, Kapitulli VI *(Trajtuar më hollësisht në faqen 45-46, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 11 & 26, datë 31.03.2016).*

5. E.K., me detyrë specialist në Sektorin e Legalizimit dhe Planifikimit Urban.

Për shkelje, të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, konkretisht:

-Në 12 praktika, objektet informale të legalizuar nuk respektojnë distancat e lejuara me strukturën e trupit të rrugës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, pikën 2/a, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", si dhe nenin 27, të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor

të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 21-26, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 4,6 & 17, datë 31.03.2016*).

-**Në 4 praktika**, sipërfaqja e legalizuar (si kufi) është më e madhe se 3 fish e bazës së objektit deri në 500 m² (për ambiente banimi), veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, i ndryshuar, me ligjin nr. 141/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, duke rënduar buxhetin e shtetit dhe rritur padrejtësisht vlerën e kompensimit të parcelave në rast shpronësimi (nga arë në truall) (*Trajtuar më hollësisht në faqen 26-34, të Raport Përfundimtar Auditimit dhe procesverbali nr. 19, datë 31.03.2016*).

C/3. Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional:

Për ish-drejtnes dhe specialistë, nuk mund të rekomandohet masë disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre, **të merren masa dhe të njoftohet Departamenti i Administratës Publike**, për masën disiplinore mbi bazën e shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për **6 ish-punonjës**, si më poshtë:

- 1. I.K., me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan 2.**
- 2. A.S., me detyrë ish-specialist në Sektorin e Çështjeve të Pronësisë.**
- 3. K.T., me detyrë ish-specialist në Sektorin e Legalizim e Planifikim Urban.**
- 4. O.H., me detyrë ish-Arkivist.**
- 5. S.V., me detyrë ish-specialist me kontratë.**
- 6. Th.L., me detyrë ish-specialist me kontratë.**

Për shkeljet:

Për të meta e mangësi, në zbatimin e akteve e normativave të ligjit për legalizimin e ndërtimeve informale, në shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për objektet informale dhe përgatitjen e dokumentacionit për kualifikimin dhe certifikimin, *më specifiket janë:*

-Nuk është respektuar neni 28, i ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", me ndryshime, pasi lejet e legalizimit nuk janë lëshuar brenda afatit 30 ditor të përcaktuar.

-Objektet e legalizuar nuk respektojnë distancat me strukturën e rrugëve, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", me ndryshime, pikën 2/a, të VKM nr. 438, datë 28.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 1.4.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", si dhe nenit 27, të VKM nr. 153, datë 07.04.2000 "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", me ndryshime.

-**Në Bashkinë Belsh**, janë kryer legalizime të objekteve në kufirin mbrojtës të liqenit, ku siç tregohet nga ortofoto dixhitale të fotografimit ajror dhe dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP Elbasan, parcelat ndërtimore të zëna, ndodhen të regjistruara në zonën përkatëse, në llojin e pasurisë "Liqen", veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore", neni 2, pika 5, nenin 3, të ligjit nr. 8093,

datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, pika 2, paragrafi 3/iii.

-Objekti i legalizuar nuk ka ruajtur distancat e lejuara me shtratin e lumit Shkumbin, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, neni 2, pika 5, nenin 3, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, VKM nr. 438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, pika 2.

-Lejet e legalizimit janë dhënë në kushtet e ekzistencës së konfliktit të interesit, pasi ish-punonjësja e ALUIZNI-t ing. V.H. në cilësinë e ish-P/Sektorit të Legalizimit Urban Elbasan 2, ka nënshkruar si akt-kualifikimin e objektit informal po ashtu edhe ekt-ekspertizën për shtesën e objektit, si drejtuese ligjore dhe teknike e shoqërisë "K" (në të njëjtën periudhë), duke mos bërë deklaratën e konfliktit të interesit, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, neni 3/ 1, neni 4/ pika 1/b, neni 7/1, etj.

-Llogaritja e vlerës dhe pagesës së tarifës për parcelës ndërtimore të zaptuar nga poseduesi në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, është bërë në referencë të VKM nr. 187, datë 06.03.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të RSH”, duke përcaktuar çmim/m² sipas zonave kadastrale, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 1620, datë 26.11.2006 “Për miratimin e çmimit të trojeve që ndodhen në të gjithë Bashkitë dhe disa Komuna”. Gjithashtu evidentohen dhe praktika ku nuk është llogaritur fare sipërfaqja e parcelës ndërtimore, duke konstatuar një **dëm ekonomik në vlerën 4,282,918 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqen 12-101, të Raport Përfundimtar Auditimit).

C/4. Për punonjësit e larguar nga detyra dhe dalë në pension:

Për ish-punonjësit E.S. me detyrë ish-specialist në Sektorin e Legalizimit e Planifikimit Urban dhe V.H. me detyrë ish-P/ Sektorin e Legalizimit e Planifikimit Urban, nuk mund të rekomandohet masë disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur kanë dalë në pension.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike e pikës 1 dhe 2 të nenit 12, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe neneve 9,11,17,22,28,57 dhe 59, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 1, datë 26.02.2016, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në germën (c dhe ç) të nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të**

vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **6 punonjës**, si më poshtë:

- 1. Z. Sh.P., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Hartografisë, në cilësinë e Kryetarit të Njësia e Prokurimit.**
- 2. Z. A.B.,specialit në Sektorin e Legalizimit Urban, në cilësinë e anëtarit të Njësia e Prokurimit.**
- 3. Z. Th.L., me detyrë ish-specialist në sektorin e legalizimit, në cilësinë e anëtarit të Njësia e Prokurimit**
- 4. Znj. B.V., me detyrë specialiste në Sektorin e Legalizim e Planifikimit Urban, në cilësinë e Kryetarit të KVO.**
- 5. Z. H.P., me detyrë specialist në Sektorin e Hartografisë, në cilësinë e anëtarit të KVO.**
- 6. Z. A.H., në cilësinë e anëtarit të KVO.**

Për arsye se:

-Hartimi i kërkesës për përcaktimin e nevojave për prokurim është bërë pa përllogaritur nevojat në mënyrë të qartë e të saktë, duke mos identifikuar dosjet më të plota nga ana dokumentare dhe më të sakta nga ana juridike që mundësojnë qëllimin e akordimit të fondit për përshpejtimin e procesit të legalizimit sipas zonave informale të shtrira dhe të klasifikuara në zona kadastrave (ZK), që do të mbulohen me këtë shërbim, veprime në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 e nenit 12, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Kreu II “Organizimi i prokurimit publik”.

-Në hartimin e specifikimeve teknike dhe licencave, nuk është bërë përcaktimi i mjeteve apo pajisjet teknike të punës, programet specifike të fushës dhe certifikimet për to, që duhet të disponohen nga ofertuesit për kryerjen e këtij shërbimi, veprime në kundërshtim me nenin 28, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Përllogaritja e vlerës limit të kontratës është barasvlerësuar me fondin në dispozicion, jo sipas përcaktimit të çmimit duke ju referuar tarifës së shërbimit prej 8,000 lekë për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik dhe objektet e dyta të miratuar me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim duke përcaktuar çmimin dhe nga raporti i tyre kanë rezultuar katet, që do të mbulohen me shërbim, *pra vlera e fondit limit nuk është përllogaritur në bazë nevojash (sasia) dhe çmimit*, veprime këto në kundërshtim nenet 9, 57, 59, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Nuk përcaktohen tarifat për rastet për objektet për banim (që është pjesa dërmuese), si dhe për rastet e shërbimit për përditësim, pra nuk ka diferencim të tarifave të shërbimit që do të kryhen sipas kateve të llojeve të objekteve.

Nga AK nuk është përcaktuar çmim i analizuar në bazë të termave të referencave, sipas zërave të këtij shërbimi, por thjesht i janë referuar kësaj tarife, për të cilën nuk ka asnjë të dhënë për analizën e kostos mbi të cilën është përcaktuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 11 nënpika 3/c, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

-Në Dokumentet Standarte të Tenderit (DST):

a. Në shtojcën 7 pika 2-Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në rubrikën “Kapaciteti teknik”, nuk është përcaktuar, që ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion për kryerjen e shërbimit, veprime në kundërshtim me pikat 2 dhe 5 e nenit 28, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

b. Në shtojcën 1-Formulari Ofertës, tek kolona “Përshkrimi i Shërbimeve” është përcaktuar vetëm 1 shërbim në total me emërtimin “Shërbimi i evidentimit në terren dhe hartimit të dokumentacionit sipas gjendjes faktike të ndërtimeve pa leje për 1 kat (njësi)” pa përcaktuar zërat përbërës të këtij shërbimi të përcaktuar në Shtojcën 11 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” dhe specifikimet teknike në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 17 “Oferta ekonomike”. Gjithashtu në ofertë është cilësuar në mënyrë të gabuar “çmimi më i ulët për kat” dhe jo “vlera më e ulët e fondit” të llogaritur.

Zbatimi i Kriteve të Veçanta të Kualifikimit:

Formulari i Ofertës: Në procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave, operatori “L & C” ka paraqitur ofertën në vlerën **7,340,000 lekë** dhe jo vlerën **7,040,000 lekë**, siç paraqitet në materialin përmbledhës për autoritetin kontraktor. Rrjedhimisht operatori i shpallur padrejtësisht fitues kalon në renditje në vend të dytë dhe jo fitues i tenderit.

Nga shqyrtimi i ofertave të tjera në vend të parë renditet operatori “La & C” me ofertë në vlerën 7,200,000 lekë, më pak se vlera e fituesit prej 140,000 lekë, veprime në kundërshtim me nenin 41 dhe 45, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, Kreu V-Marrëveshja kuadër. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një prokurim ku çmimet e tregut nuk kanë ndryshime për një kohe të gjatë dhe nuk kanë periudha pik, veprime këto që nuk diktojnë nevojën e marrëveshjes kuadër. Gjithashtu nga komisioni i vlerësimit të ofertave nuk është bërë analiza e elementeve që formojnë strukturën e çmimit për të bërë të mundur ruajtjen e cilësisë së shërbimit.

Kontrata e shërbimit: Me shkresë nr. 4168 datë 03.11.2015, është lidhur kontratë shërbimi midis Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan përfaqësuar nga ish-Drejtori ALUIZNI z. A.L.L. dhe operatorit ekonomik “L & C” me administrator z. L. Z.

Në pikën 3.2 të nenit 3 të kontratës, cilësohet se vlera ofruar nga kontraktuesi për njësi kati është **7,040 lekë** (pa tvsh), veprim në kundërshtim me pikën 2, të VKM nr. 860 datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, ku thuhet se: *Tarifa për legalizim për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik si dhe objektet e dyta në kuptim të nenit 25 të ligjit 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar*, është në vlerën **8,000 lekë/kati**.

Nga auditimi rezulton se firma “L & C” nuk është fituese, për rrjedhojë kontrata duhet të lidhej me firmën fituese “La & C”, sipas ofertës së paraqitur për vlerën 7,200,000 lekë (për 1000 kate).

Gjithashtu, në pikën 3.3 të nenit 3 të kontratës, vlera e lidhur paraqiten në shumën 8,000,000 (tetëmilion) lekë (pa tvsh), ndërkohë që nga konkurrentët është paraqitur vlera më e ulët prej 7,200,000 (shtatëmilion e dyqindmijë) lekë (pa tvsh), me një diferencë prej 800,000 lekë, veprime këto në kundërshtim me nenin 77, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e Prokurimit Publik”.

Me Urdhër shpenzimi nr. 195, datë 30.12.2015, faturë tatimore e shitjes nr. 0692095123 datë 23.12.2015 është likuiduar shuma 9,600,000 lekë në favor të operatorit “L & C” sh.p.k, kur duhej likuiduar shuma 8,640,000 me tvsh (7,200,000 x 20 %), pra më shumë vlera **960,000 lekë, si dëm ekonomik** (Trajtuar në faqen 110-113, të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalin nr. 1, datë 25.03.2016).

E. KALLËZIM PENAL:

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika “gj” e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 ”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", bëjmë kallëzim penal për 3 punonjës, si më poshtë:

1. I.K., me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Elbasan 2.
2. V.H., me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Legalizim e Planifikim Urban.
3. H.P., me detyrë specialist në Sektorin Hartografisë, në cilësinë e ish-specialistit të Sek/Çështjeve të Pronësisë.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R